# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8264
E martë, 17 mars 2026
Çmimi 0. 50 €

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


## Jeton Koca jep dorëheqje nga pozita e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë

FAQE 7




AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# BLLOKADA NË KUVEND RREZIKON FATIN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE 121-MILIONËSHE



Kuvendi i Kosovës ka kohë deri më 31 mars që ta ratifikojë marrëveshjen e kredisë mes Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin "Energjia Diellore Fotovoltaike" në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), në vlerë prej 33 milionë eurosh. Por, e gjithë puna e Kuvendit është e ngrirë deri në këtë datë nga Gjykata Kushtetuese, përmes masës së përkohshme të vënë pas kontestimit të dekretit të presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e legjislaturës së dhjetë. Zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Arlind Manxhuka, ka thënë se afatet për miratimin e këtyre marrëveshjeve janë të ngushta dhe "kërkojnë procedim të shpejtë nga ana e Kuvendit"



## RINIA E PDK-së, AKSION SIMBOLIK PARA QEVERISË, ZBRAZ THESIN ME "MASHTRIMET E KURTIT PËR STRUKTURAT PARALELE"

F. 3

## NJË VIT NGA VDEKJA E BABAIT TË ISH-PRESIDENTIT THAÇI, NJË HUMBJE QË PREKU TË GJITHË SHQIPTARËT

F. 5



## AKTUALE



### SHBA-ja pritet të paraqesë një koalicion për shoqërim anijesh në Hormuz

F. 2

### Çmim Oscar për filmin ku luan aktorja me prejardhje nga Kosova, Luana Bajrami

F. 6

### Orav në takim lamtumirës me Osmanin: BE-ja është partnerja më e besueshme e Kosovës

F. 3

## EKONOMI



### BQK-ja hap aktivitetet e Javës Globale të Parasë 2026, ndan çmimet e garave dhe shpall "Çmimin për Ekonomistë të Rinj"

F. 8

### ASK-ja: Ekonomia e Kosovës u rrit për 3.85 % në fund të vitit 2025

F. 8

## SPORT



### Ademi takohet me Konjufcën, merr mbështetje për rrugëtimin e Kosovës drejt Kupës së Botës

F. 11


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# SHBA-ja PRITET TË PARAQESË NJË KOALICION PËR SHOQËRIM ANIJESH NË HORMUZ



**Uashington, 16 mars** - Shtetet e Bashkuara janë afër paraqitjes të një koalicioni për t'i shoqëruar anijet nëpër Ngushticën e Hormuzit, kanë raportuar mediet "Wall Street Journal" dhe "Axios", teksa Irani ka paralajmëruar se nuk do të dorëzohet. "Nisur nga kjo javë, administrata Trump planifikon të bëjë të ditur që shumë shtete janë pajtuar të formojnë një koalicion për t'i shoqëruar anijet nëpër Ngushticën e Hormuzit", ka raportuar "Wall Street Journal" më 15 mars, duke mos cituar me emra burimet amerikane. Sipas raportimeve, kjo çështje është duke u diskutuar dhe që gjërat mund të lëvizin varësisht prej gjendjes së luftës. Diskutime ka edhe mes pjesëmarrësve se kur mund të nisë punën ky mision - teksa zgjasin luftimet apo vetëm pas një armëpushimi, raporton REL.

Axios, duke cituar burimet e veta, ka raportuar më vonë se presidenti amerikan Donald Trump shpreson ta bëjë të ditur këtë koalicion në javën në vazhdim dhe që është duke e shqyrtuar mundësinë e kapjes së Ishullit strategjik të Hargut - të cilin forcat ushtarake amerikane e bombarduan më 13 mars - në rast se trafiku vazhdon të mbetet i bllokuar në ngushticë.

Në një postim në rrjetet sociale, presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se "shtetet e botës që pranojnë naftën përmes Ngushticës së Hormuzit duhet të kujdesen për atë zonë, dhe ne do të ndihmojmë shumë".

Në një intervistë të publikuar më 16 mars nga "Financial Times", Trumpi ka thënë se forcat e NATO-s përballen me një "të ardhme shumë të keqe" nëse një vend anëtar nuk i ndihmon Shtetet e Bashkuara në Iran.

Më 15 mars, kryeministri britanik Keir Starmer ka biseduar me Trumpin për rëndësinë e rihapjes së Ngushticës së Hormuzit në mënyrë që të mos pengohen furnizimet globale, ka bërë të ditur Zyra e kryeministrit britanik.

Starmeri ka diskutuar për këtë çështje edhe me kryeministrin kanadez Mark Carney, me të cilin kanë diskutuar se si bllokada në ngushticë është duke prekur furnizimet globale. Ata janë zotuar se do t'i vazhdojnë diskutimet më 16 mars.

### Shqetësimet për krizë të energjisë

"Wall Street Journal" ka raportuar edhe se kompani amerikane të naftës kanë paralajmëruar administratën amerikane se kriza me energjinë që është shkaktuar nga lufta në Iran ka mundësi të përkeqësohet. Sipas gazetës, pas takimeve të njëpasnjëshme të zyrtarëve amerikanë me udhëheqësit e kompanive më të mëdha të naftës në ShBA, pengesat në ngushticë "do të vazhdojnë të krijojnë armiqësi në tregjet globale të energjisë".

Për më tepër, sipas gazetës, nëse forcat ushtarake do ta nisin shoqërimin e anijeve nëpër Hormuz teksa armiqësitë janë në zhvillim e sipër, atëherë kjo gjë do të shënojë fazë të re të rrezikshme në luftën e ShBA-së dhe Izraelit ndaj Iranit.

Teherani ka nisur sulme drejt aleatëve arabë të ShBA-së në rajon dhe mund t'i shënjestrojë anijet e huaja në ngushticë, ndonëse Trumpi dhe zyrtarë të tjerë amerikanë kanë thënë se marina e Iranit është shkatërruar gjatë sulmeve ajrore të ShBA-së dhe Izraelit.

Pavarësisht se është goditur nga këto dy shtete prej ajrit, Irani vazhdon të nisë sulme me dronë dhe raketa kundër Izraelit dhe aleatëve arabë të ShBA-së në rajon.

Ministri i Jashtëm Iranian, Abbas Araqchi, e ka hedhur poshtë një pretendim të Trumpit se Teherani po kërkon të negociojë me Uashingtonin. Trumpi ka thënë se nuk është gati për bisedime sepse "kushtet e Teheranit nuk janë mjaftueshëm të mira".

### Iraku vëren pasojat e luftës

Ndërkohë, Iraku vazhdon t'i vërejë pasojat e luftës në shtetin fqinj, pasi autoritetet atje janë duke raportuar për sulme të shumëfishta, ose kundër grupeve të afërta me Iranin, ose në bazat amerikane.

Autoritetet irakiane kanë thënë se pesë persona janë plagosur më 15 mars në një sulm me raketë në kompleksin e aeroportit të Bagdadit, ku gjendet një objekt diplomatik amerikan.

Në aeroportin e Bagdadit gjendet edhe një kompleks i madh ushtarak, një qendër burgu ku mbahen shumë të dyshuar për terrorizëm si dhe një qendër diplomatike dhe logjistike e ShBA-së.

Prej nisjes së luftës, Iraku e ka mbyllur hapësirën e vet ajrore në gjithë shtetin.

Iraku konsiderohet aleat i ShBA-së, por aty ka edhe populli të madhe shiite dhe milici e forca politike të lidhura me Iranin.

Milicitë e lidhura me Iranin kanë thënë të kenë kryer sulme ditore me dronë dhe raketa kundër bazave amerikane.

Ndërkohë, zëdhënësi i ushtrisë izraelite, Effie Defrin, ka thënë se Izraeli ka ende mijëra shënjestra për t'i goditur brenda Iranit. "Ne ende kemi mijëra shënjestra brenda Iranit dhe jemi duke identifikuar shënjestra të reja çdo ditë", ka thënë ai.

Mes të tjerash, Izraeli është duke vazhduar sulmet ndaj qendrave ku besohet se strehohen pjesëtarë të Hezbollahut në Liban.

Hezbollahu konsiderohet organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe fuqi tjera.

Ushtria izraelite ka thënë më 15 mars se është duke goditur infrastrukturën e Hezbollahut në jug të Bejrutit, pas bastisjeve që janë kryer më parë më afër kufirit.

# UKRAINA KËRKON PARA E TEKNOLOGJI NË KËMBIM TË OFRIMIT TË NDIHMËS PËR LINDJEN E MESME RRETH DRONËVE



**Kiev, 16 mars** - Ukraina dëshiron para dhe teknologji në këmbim të dhënies së ndihmës për vendet e Lindjes së Mesme, të cilat po kërkojnë mënyra se si të mbrohen nga dronët kamikazë iranianë, tha presidenti Volodymyr Zelensky.

Zelensky u tha gazetarëve se tri ekipe specialistësh u dërguan në Lindjen e Mesme për të kryer vlerësime ekspertësh dhe për të treguar se si duhet të veprojë mbrojtja kundër dronëve.

Fillimisht, këtë javë, ai tha se ekipet ishin dërguar në Katar, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Arabinë Saudite, si dhe në një bazë ushtarake amerikane në Jordani. "Kjo nuk ka të bëjë me përfshirjen tonë në operacione. Ne nuk jemi në luftë me Iranin", tha Zelensky. Ai shtoi se marrëveshje më themelore dhe afatgjatë për dronët mund të negocioheshin me vendet e Gjirit dhe se ende duhej diskutuar se çfarë do të merrte Ukraina në këmbim të kësaj ndihme. "Për ne sot, si teknologjia ashtu edhe financimi janë të rëndësishme", tha Zelensky.

Shtetet e Gjirit kanë shpenzuar sasi të mëdha raketash kundërajrore për t'i luftuar dronët Shahed të Iranit.

Kiev përdor çdo natë një sërë armësh për të rrëzuar dronët rusë, duke përfshirë dronë më të vegjël dhe më të lirë ose pajisje për pengim sinjalesh.

Zelensky ka thënë se ShBA-ja, si dhe vende nga Europa, Lindja e Mesme dhe Afrika, kanë kërkuar ndihmë nga Ukraina se si t'i luftojnë këto sulme.

Megjithatë, presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se ShBA-ja nuk ka nevojë për ndihmën e Ukrainës për të rrëzuar dronë.

Zelensky tha se nuk e di pse Uashingtoni nuk ka nënshkruar marrëveshje të madhe për dronët, për të cilën Kiev ka insistuar muaj me radhë dhe se nuk është i sigurt nëse një marrëveshje e tillë do të pranohej. "Dëshiroja të nënshkruaja një marrëveshje me vlerë rreth 35 - 50 miliardë dollarë", tha ai.

Zelensky shprehu shqetësimin për ndikimin e konfliktit të zgjatur në Lindjen e Mesme mbi furnizimet e Ukrainës me raketa kundërajrore. "Ne nuk do të donim aspak që Shtetet e Bashkuara të tërhiqeshin nga çështja e Ukrainës për shkak të Lindjes së Mesme", u tha ai gazetarëve.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

## Orav, takim lamtumirës me Osmanin: BE-ja është partnerja më e besueshme e Kosovës

Prishtinë, 16 mars - Ambasadori i Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Aivo Orav, ka zhvilluar një takim lamtumirës me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani. Në këtë takim, sipas njoftimit të Zyrës së BE-së, Orav ka falënderuar Osmanin për bashkëpunimin, duke shtuar se Bashkimi Evropian mbetet partnerja më e besueshme e Kosovës. "Në një takim lamtumirës sot, Aivo Orav falënderoi presidenten e Kosovës Vjosa Osmani për bashkëpunimin gjatë mandatit të tij si ambasador i BE-së në Kosovë, duke theksuar se BE-ja mbetet partneri më i fortë dhe më i besueshëm i Kosovës ndërsa vendi avancon drejt BE-së" është thënë në njoftimin e Zyrës së BE-së.



# RINIA E PDK-së, AKSION SIMBOLIK PARA QEVERISË, ZBRAZ THESIN ME "MASHTRIMET E KURTIT PËR STRUKTURAT PARALELE"

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 16 mars - Rinia Demokratike e Kosovës ka realizuar të hënën një aksion simbolik para Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit ka shprehur shqetësimin e thellë për vendimin e fundit të kësaj qeverie për legalizimin e përdorimit të dokumenteve të Serbisë nga personat që nuk i kanë ato të Kosovës. Ata kanë zbrazur një thes me lajme të deklaratave të kryeministrit Albin Kurti ndër vite duke u mburrur se në Kosovë nuk ka më struktura paralele të Serbisë.

Kryetarja e RDK-së, njëherësh deputete e PDK-së, Arbnora Salihu, tha se ky aksion është një mesazh i qartë se e vërteta nuk mund të mbulohet me propaganda dhe se dështimi nuk mund të fshihet pas fjalëve boshe e të pakuptimta. "E kemi mbushur këtë thes me gënjeshtrat e Albin Kurtit, i cili deklaronte që i ka çrrënjosur strukturat paralele në pjesën veriore të vendit. Ky thes e shpërfaqë qasjen e tij manipulative, me fjalë të mëdha në emër të patriotizmit dhe me vepra në dëm të interesit shtetëror", shtoi ajo.



Salihu rikujtoi disa nga deklarata e Kurtit me të cilat ka ndërtuar narrativë të rreme dhe i ka mashtruar qytetarët. "Në prill të vitit 2022 Kurti premtonte se nuk do të kishte 'asnjë gram tolerancë' ndaj strukturave ilegale. Në qershor 2023 ai deklaronte se 'Kosova nuk do të lejojë struktura paralele në veri' dhe madje kërcënonte se ata do të shkonin 'ose në Serbi, ose në burg'. Në janar 2025 ministrat e tij mburreshin se "epoka e komunave paralele ka përfunduar". Ndërsa në janar të këtij viti, në Davos, Albin Kurti thoshte se 'Në Kosovë nuk ka më struktura paralele të Serbisë'. Por, para dy ditësh, më 14 mars 2026, ai bëri të kundërtën, lejoi përdorimin e letërnjoftimeve të lëshuara nga Serbia, duke i bërë ato pjesë të sistemit ligjor të Kosovës", vuri re ajo.




RDK-ja e cilëson këtë vendim si dorëzim përballë bandave kriminale që krijon një momentum të rrezikshëm për të ardhmen e vendit. "Për më tepër, ky kompromis i dhimbshëm u përshëndet nga Serbia, e cila e konsideron si shmangie katastrofe. Përderisa Albin Kurti flet për mbyllje të strukturave ilegale, Aleksandër Vuçiq po feston për fitore", theksoi Salihu.

Ajo tha se Kosova meriton stabilitet, zhvillim dhe seriozitet, jo populizëm dhe hipokrizi politike. "Kur një kryeministër që ka ndërtuar karrierën mbi retorikë të ashpër ndaj Serbisë, përfundon duke i dhënë legjitimitet dokumenteve të saj, atëherë kemi të bëjmë me mashtrim. Ky vendim i Albin Kurtit është tradhti ndaj shtetit dhe qytetarëve. Është paradoksale dhe shqetësuese që një kryeministër, i cili nuk arriti të gjejë konsensus politik për zgjedhjen e presidentit, sot gjen gjuhë të përbashkët me strukturat paralele dhe me Serbinë. Prandaj, nga këtu i bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës që t'i ndalë politikat e dyfishta dhe të mos i mashtrojë më qytetarët tanë", përfundoi deputetja Salihu.

## Hamza nënshkruan peticionin kombëtar në mbështetje të liderëve të UÇK-së

Prishtinë, 16 mars - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka njoftuar se ka nënshkruar peticionin kombëtar në mbështetje të liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, të cilët janë duke u gjykuar në Hagë. Ai ka theksuar se lufta çlirimtare ishte mbrojtëse, e drejtë dhe është i bindur se drejtësia së shpejti do ta rikonfirmojë këtë. "Sot e nënshkrova peticionin kombëtar në mbështetje të presidentit Thaçi, kryetarit Veseli, bacës Jakup, Rexhës dhe të gjithë bashkëluftëtarëve të tyre që po gjykohen në Hagë. Është detyrë e secilit prej nesh që t'u qëndrojë pranë atyre që kontribuan me vite të tëra për lirinë dhe shtetin tonë. Lufta çlirimtare ishte mbrojtëse, e drejtë dhe jam i bindur se drejtësia së shpejti do ta rikonfirmojë këtë", ka shkruar Hamza në "Facebook".





# BLLOKADA NË KUVEND RREZIKON FATIN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE 121-MILIONËSHE

PRISHTINË, 16 MARS - Kuvendi i Kosovës ka kohë deri më 31 mars që ta ratifikojë marrëveshjen e kredisë në mes të Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin "Energjia Diellore Fotovoltaike" në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), në vlerë prej 33 milionë eurosh. Por, e gjithë puna e Kuvendit është e ngrirë deri në këtë datë nga Gjykata Kushtetuese, përmes masës së përkohshme të vënë pas kontestimit të dekretit të presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e legjislaturës së dhjetë.

Marrëveshja për projektin që prek KEK-un është një nga tetë sosh sa i ka legjislatura aktuale në sirtarët e saj.

Ndër to janë edhe: Marrëveshja për anëtarësimin e Kosovës në Bordin e Paqes; Marrëveshja për qasje në arsimin e lartë dhe pranim për studime në Ballkanin Perëndimor; Dy amendamente të marrëveshjes financiare mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA; Dy marrëveshje për kredi me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH): njëra për projektin e eficencës së energjisë në ndërtesa publike dhe për impiante për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë dhe Marrëveshja për kredi me Fondin Saudit për Zhvillim për projektin e rrugës Prishtinë-Mitrovicë.

Vlera e katër prej këtyre marrëveshjeve, duke përfshirë edhe atë me Bankën Evropiane për Investime, shkon në 121 milionë euro.

Zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Arlind Manxhuka, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se afatet për miratimin e këtyre marrëveshjeve janë të ngushta dhe "kërkojnë procedim të shpejtë nga ana e Kuvendit".

Nga Banka Evropiane e Investimeve thanë se ratifikimi i marrëveshjes "është i nevojshëm për ofrimin e financimit të propozuar". "Ratifikimi i marrëveshjes do t'i mundësonte Kosovës të ecë përpara me ndërtimin e njërit prej centraleve të saj më të mëdha fotovoltaike diellore, me një kapacitet deri në 100 megavatë. Projekti pritet të forcojë sigurinë energjetike të vendit duke rritur pjesën e energjisë së rinovueshme të prodhuar në vend dhe duke zvogëluar varësinë nga gjenerimi me bazë qymyri. Ai gjithashtu do të mbështeste qëllimet më të gjera të tranzicionit të gjelbër të Kosovës, pasi centrali pritet të gjenerojë rreth 169 gigavatë energji elektrike në vit dhe do t'i ulte ndjeshëm emetimet e dyoksidit të karbonit sapo të vihet në funksion".

## Vlera e marrëveshjeve

Njohës të punës së Kuvendit konsiderojnë se marrëveshjet kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe në forcimin e pozitës ndërkombëtare të Kosovës. "Në thelb, ratifikimi i këtyre marrëveshjeve nënkupton përshpejtim të investimeve publike, rritje të stabilitetit institucional dhe përfitime konkrete afatmesme dhe afatgjata për qytetarët", tha për Radion Evropa e Lirë, Melos Kolshi, hulumtues në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD).

Por, sipas hulumtueses së Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Violeta Haxholli, situata aktuale "krijon një pasiguri institucionale". "Meqenëse marrëveshjet ndërkombëtare duhet të ratifikohen nga Kuvendi me shumicë të kualifikuar prej dy të tretave, çdo bllokim në funksionimin e tij e shtyn automatikisht edhe procesin e ratifikimit. Kjo do të thotë se, derisa të ketë një qartësi për funksionimin e plotë të legjislativit, është e vështirë të parashikohet se kur mund të procedohen këto marrëveshje për miratim", tha ajo.

Nga Lëvizja Vetëvendosje, parti në pushtet, thanë se këto marrëveshje kanë planifikuar t'i miratojnë të premten e 6 marsit, një ditë pas dështimit për ta zgjedhur presidentin e ri. Seanca nuk u mbajt pasi Osmani nxori në mëngjesin e asaj dite dekretin për shpërndarje të Kuvendit.

Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, i tha Radios Evropa e Lirë se këto katër marrëveshje "kanë rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik, përmirësimin e infrastrukturës, mbrojtjen e mjedisit dhe rritjen e efiçiencës energjetike në vend". "Prandaj, miratimi i tyre sa më i shpejtë është në interes të drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës. Në rrethana të tilla, është e rëndësishme që këto projekte strategjike të mos mbeten peng i zhvillimeve politike, por të avancohen sa më parë për të sjellë përfitime konkrete për vendin dhe qytetarët".

## Pasojat e mosratifikimit të marrëveshjeve

Violeta Haxholli thotë se mosratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare ndikon në vonesat për zbatimin e projekteve dhe në imazhin e shtetit në arenën ndërkombëtare. "Edhe pse partnerët ndërkombëtarë zakonisht i kuptojnë situatat e brendshme politike, vazhdimi i bllokadave institucionale mund të ndikojë në ritmin e bashkëpunimit dhe në besimin për zbatimin e projekteve të përbashkëta", tha ajo.

Kolshi sheh pasoja të shumëfishta, edhe brenda edhe jashtë Kosovës. "Në një kontekst global të ndryshimeve gjeopolitike dhe rikonfigurimit të prioriteteve të politikës së jashtme të aktorëve të mëdhenj ndërkombëtarë, përfshirë edhe administratën amerikane, është jetike që Kosova të dëshmojë seriozitet institucional dhe kapacitet vendimmarrës për t'i ruajtur dhe forcuar partneritetet strategjike".

Radio Evropa e Lirë i ka pyetur edhe institucionet tjera që i sponsorojnë këto marrëveshje - BE-në, BERZH-in dhe Fondin Saudit për Zhvillim - se me çfarë pasojash eventuale mund të përballet Kosova nga pamundësia për t'i ratifikuar dokumentet, por nuk ka marrë ndonjë përgjigje.

## Domosdoshmëria e konsensusit politik

Duke marrë parasysh faktin që për miratim të marrëveshjeve ndërkombëtare nevojiten dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, konsensusi politik është kyç.

Hulumtuesja e KDI-së, Haxholli, përmend se është shumë e

# NJË PERSON VRITET NË GJAKOVË, AUTORITETET NË KËRKIM TË DORASIT TË DYSHUAR

GJAKOVË, 16 MARS - Një person është vrarë dhe një tjetër ka mbetur i plagosur në Gjakovë më 16 mars teksa autoritetet thanë se janë në kërkim të dorasit të dyshuar.
Policia në Gjakovë tha se në orën 05:30 të 16 marsit mori informacion se dy persona të moshës madhore ishin qëlluar me armë zjarri.
Një nga ta, sipas zëdhënësit të policisë, Sheremet Elezaj, vdiq në vendin e ngjarjes nga plagët e marra.
Prokuroria Themelore në Gjakovë konfirmoi se i dyshuari është identifikuar dhe autoritetet po ndërmarrin veprime për ta arrestuar atë. "Atë që mund ta ndajmë tash është se në vendin e ngjarjes janë gjetur disa gëzhoja të armës së zjarrit, po ashtu është gjetur edhe një armë e ftohtë. Kjo është e gjitha që mund të ndajmë me publikun aktualisht", tha zëdhënësi i policisë, Sheremet Elezaj, në një konferencë për medie.
Deri më tani autoritetet nuk kanë dhënë hollësi për motivin e dyshuar të kësaj ngjarjeje.
Prokuroria e Shtetit ka iniciuar rast për veprën penale vrasje e rëndë.
Vitet e fundit janë regjistruar një sërë rastesh të dhunës me armë zjarri në Kosovë, që kanë çuar edhe në vrasje. Mijëra armë zjarri pa leje llogaritet të jenë në duart e qytetarëve të Kosovës. Ekspertët argumentojnë se është i nevojshëm konfiskimi i tyre me qëllim që të ulet numri i incidenteve të armatosura.



# NJË VIT NGA VDEKJA E BABAIT TË ISH-PRESIDENTIT THAÇI, NJË HUMBJE QË PREKU TË GJITHË SHQIPTARËT




Skenderaj, 16 mars - Të hënën vëllezërit Thaçi prisnin njerëz nga të gjitha trojet shqiptare në odën e tyre, në shenjë solidarizimi të dyfishtë: Edhe për përvjetorin e parë të vdekjes së prindit, edhe për faktin që edhe pas një viti ish-presidenti Thaçi nuk është i pranishëm në mesin e tyre, i cili po mbahet në paraburgim në Hagë për më shumës e pesë vjet.
Ish-këshilltari i Hashim Thaçi, Ismail Syla, ka thënë se sa herë që ka ardhur në Burojë, baca Haxhi e kishte pritur me një dashuri dhe respekt të veçantë. "Ai i ruajti tiparet e burrërisë, bujarisë dhe njerëzisë deri në frymën e fundit. Shkoi në atë botë me mallin që të birin, presidentin Hashim Thaçi, nuk e pa të lirë për së gjalli. Me çfarë padrejtësie ballafaqohet Familja Thaçi, Kosova dhe shqiptarët është paradoks i shekullit njëzet e një. Në varrezën e re të Barojës prehet trupi i Haxhi Thaçit nën pllakën e granitit ku duket qartë përkushtimi i përjetshëm: 'Jetove me besë, nder e bujari/ Prehu në tokën e Atdheut të lirë./ Gjithmonë në zemrat tona / Familja Thaçi'. Ndërsa në kurorën e vënë në emër të [presidentit Thaçi shkruhej 'Gjithmonë i gjallë kujtimi dhe dashuria për ty Baba / Përherë në mendje dhe zemër të birit tënd, Hashimit'. Lavdi jetës dhe emrit të Haxhi Thaçit!", ka shkruar në "Facebook".

# GJERMANIA: INSTITUCIONET TA RESPEKTOJNË VENDIMIN E KUSHTETUESES SAPO AI TË MERRET

Prishtinë, 16 mars - Ambasada e Gjermanisë në Kosovë ka kërkuar nga përfaqësuesit e institucioneve ta respektojnë plotësisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës sapo ai të merret.
Ambasada e Gjermanisë nuk i ka komentuar pretendimet e zyrtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje se ambasadorët, përmes vizitave të tyre në Kushtetuese, po ndërhyjnë në këtë institucion. "Ambasada gjermane nuk komenton proceset aktuale të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ne presim që të gjitha institucionet ta respektojnë plotësisht vendimin e Gjykatës Kushtetuese sapo ai të merret", është thënë në përgjigjen e Ambasadës së Gjermanisë.
Ky qëndrim i Ambasadës vjen në një kohë kur zyrtarët e LV-së kanë kërkuar nga Gjykata Kushtetuese të vendosë në favor të kërkesës së tyre që dekreti i presidentes Vjosa Osmani të shpallet kundërkushtetues.



rëndësishme që marrëveshjet të trajtohen "përtej interesave të momentumit politik". "Në shumicën e rasteve, këto marrëveshje lidhen me zhvillimin e vendit, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët. Prandaj, është e rëndësishme që debati politik të fokusohet në përmbajtjen dhe përfitimet e tyre, duke siguruar që procesi i ratifikimit të zhvillohet në mënyrë transparente dhe në kohë", theksoi ajo.
E Kolshi nga IKD-ja thotë se Kuvendi tashmë është përballur me vonesa "të konsiderueshme". "Përgjegjësi e veçantë bie edhe mbi Qeverinë aktuale, e cila përveç rolit negociues në marrëveshje ndërkombëtare, duhet të tregojë lidership politik dhe kapacitet për të ndërtuar konsensus institucional dhe stabilitet me Kuvendin dhe aktorët e tjerë politikë".
Kjo nuk është hera e parë që Kosova rrezikon t'i humbë fondet nga marrëveshjet ndërkombëtare, për shkak të problemeve të brendshme. Legjislatura aktuale mezi i arriti afatet e nevojshme për të përfituar nga marrëveshjet me Bankën Botërore dhe atë me BE-në në kuadër të Planit të Rritjes. Shuma e tri marrëveshjeve në total prek vlerën e rreth 1 miliard eurove.

# ‘VIT I HUMBUR PËR KOSOVËN’, BAJRAMI KRITIKON QEVERINË KURTI PËR DRAFT-RAPORTIN E HARTUAR NGA PE-ja



**Prishtinë, 16 mars** - Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka reaguar pas publikimit të draft-raportit të Parlamentit Evropian për Kosovën, duke thënë se viti 2025 është cilësuar “vit i humbur” për vendin për shkak të krizës politike dhe bllokadave institucionale. Sipas saj, në “DRAFT REPORT on the 2025 Commission report on Kosovo (2025/2252(INI))”, i publikuar më 6 mars 2026 nga raportuesi Riho Terras në Komisioni për Punë të Jashtme i Parlamentit Evropian (AFET), theksohet se viti 2025 ka qenë një periudhë pa përparim për Kosovën. “Viti 2025 ishte vit i humbur (lost year) për Kosovën për shkak të paralizës politike pas zgjedhjeve të shkurtit 2025: pa Kuvend funksional, pa qeveri me mandat të plotë”, ka shkruar Bajrami në “Facebook”. Sipas saj, raporti vë në pah se kjo situatë ka ndikuar negativisht në proceset reformuese dhe në integrimin evropian të vendit. “Sipas raportit, kjo gjendje bllokoi reformat, dialogun, fondet e BE-së dhe Planin e Rritjes, pati mungesë të përparimit në sundimin e ligjit, mungesë të lirisë së mediave (rënie për 24 vende në Indeksin e lirisë së medias), mungesë në luftën kundër krimit të organizuar dhe mungesë në reforma në administratën publike”, u shpreh ajo.

Deputetja thekson se në raport përmendet edhe rënia e Kosovës në indeksin global të korrupsionit. “Kosova ka rënë 3 vende në indeksin global të korrupsionit për 2025 në krahasim me 2024. Raporti shpreh shqetësim të madh për progresin e kufizuar në luftën kundër korrupsionit në përgjithësi dhe kërkon reforma të thella në sundimin e ligjit, sepse pa reforma integrimi evropian mbetet peng”, tha ajo.

Sipas Bajramit, Parlamenti Evropian ka shprehur shqetësim edhe për zhvillimet e fundit politike në vend, përfshirë procesin e zgjedhjes së presidentit. Ajo ka kritikuar edhe situatën aktuale politike, duke thënë se kriza institucionale po vazhdon edhe në vitin 2026. “Pas një viti të humbur në 2025, humbja po vazhdon edhe në 2026, Kosova është me Kuvend të suspenduar deri më 31 mars e më pas, sipas të gjitha gjasave, zgjedhje parlamentare sepse LV-ja i do krejt për vete dhe asgjë për Kosovën”, ka shkruar deputetja.

Në reagimin e saj, Bajrami ka kritikuar edhe kryeministrin Albin Kurti dhe Lëvizjen Vetëvendosje, duke thënë se qasja e tyre po çon vendin drejt zgjedhjeve të reja. “Kjo nuk është demokraci, ky është pengim i qëllimshëm i institucioneve”.

Në fund, ajo ka bërë thirrje për reflektim qytetar dhe përgjegjësi politike. “Andaj ka ardhur koha për reflektim të vërtetë qytetar, t’i themi stop arrogancës së partive politike, atyre që shtetin po e konsiderojnë si lodër argëtimi. Askush, ama askush nuk ka të drejtë të abuzojë me besimin e qytetarëve”, u shpreh Bajrami.

# ÇMIM OSCAR PËR FILMIN KU LUAN AKTORJA ME PREJARDHJE NGA KOSOVA, LUANA BAJRAMI

**Prishtinë, 16 mars** - Filmi “Two People Exchanging Saliva” [Dy njerëz që shkëmbejnë pështymë] është shpërblyer me Çmim Oscar në kategorinë e filmit të shkurtër, në ceremoninë e mbajtur në Los Anxhelos të Shteteve të Bashkuara të dielën.

Aktorja dhe regjisorja me prejardhje nga Kosova, Luana Bajrami, e ka pranuar çmimin bashkë me pjesën tjetër të ekipit. Kur u përmend prejardhja e pjesëmarrësve në film, Bajrami u përshkrua si aktore nga Kosova. Filmi u duartrokit edhe për faktin që është realizuar nga një shumicë grash.

Bajrami, 25-vjeçare, ka lindur në Kosovë, mirëpo familja e saj është shpërngulur në Francë dhe jeton atje.

Luana e luan rolin e Malaises, një gruaje të re në këtë film bardhezi, i cili është bashkëprodhim mes Francës dhe Shteteve të Bashkuara.

Filmi e ka në qendër intimitetin dhe konsumizmin në një versioni distopian të Parisit, ku prekja romantike, veçanërisht puthja, është e ndaluar dhe e dënueshme me vdekje.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka përgëzuar Bajramin dhe gjithë ekipin për çmimin e fituar. “Jemi krenarë me këtë arritje të madhe të Luanës, aktores së patrembur, të lindur në Kosovë e cila përfaqëson më të mirën e të rinjve tanë: talentin, vendosmërinë dhe besimin për t’i ndjekur edhe ëndrrat më të



Luana Bajrami (e dyta majtas, rreshti mbrapa) gjatë pranimit të Çmimit Oscar.

mëdha”, ka thënë Osmani përmes një postimi në rrjete sociale.

Filmi e ka ndarë këtë çmim bashkë me filmin tjetër “The Singers”, [Këngëtarët] - vendim i rrallë në ndarjen e këtyre çmimeve.

Në ceremoninë e ndarjes së çmimeve Oscars, Akademia e Arteve në ShBA nderon yjet e kinematografisë botërore.

Filmi “One Battle Afte Another” (Betejë pas beteje) është shpërblyer me gjashtë çmime, përfshirë çmimin për filmin më të mirë.

Vetë Kosova ka tre vjet që nuk ka garuar me asnjë film për Oscars në kategorinë e filmit më të mirë ndërkombëtar.

Suksesi më i madh i vendit është shënuar më 2016 me filmin “Shok” me regji dhe skenar të regjisorit britanik Jamie Donoughue, i luajtur nga aktorë të Kosovës dhe i xhiruar në Kosovë. Ai ishte filmi i parë që përfaqësoi kinematografinë e Kosovës në këtë ceremoni.

## Rritet numri i lindjeve në muajin janar 2026 krahasuar me muajin dhjetor 2025

**Prishtinë, 16 mars** - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat preliminare në bazë mujore për lindjet, vdekjet, kurorëzimet dhe shkurorëzimet për muajin janar 2026.

Në muajin janar 2026 janë regjistruar 2 308 lindje (brenda dhe jashtë Kosovës).

Prej këtyre lindjeve të regjistruara 1 196 lindje ishin meshkuj dhe 1 112 lindje ishin femra. Krahasuar muajin janar 2026 me muajin dhjetor 2025, numri i lindjeve ishte rritur për rreth 2 %.

Gjatë muajit janar 2026 janë regjistruar gjithsej 1 143 raste të vdekjeve (brenda dhe jashtë Kosovës).

Nga gjithsej vdekjet e regjistruara, 605 ishin meshkuj dhe 538 ishin femra. Krahasuar muajin janar 2026 me muajin dhjetor 2025, numri i rasteve të vdekjeve ishte rritur për 6,8 %.

Në muajin janar 2026 janë regjistruar gjithsej 1 372 kurorëzime (brenda dhe jashtë Kosovës). Krahasuar muajin janar 2026 me muajin dhjetor 2025, numri i kurorëzimeve ishte më i vogël për (-8,5 %).

Në këtë periudhë janë regjistruar 88 raste të shkurorëzimeve në Kosovë. Krahasuar muajin janar 2026 me muajin dhjetor 2025 numri i shkurorëzimeve ka rënie për -33,8 %.



## Zotëria i Parë, Prindon Sadriu, ftohet në Shtëpinë e Bardhë nga Zonja e Parë e ShBA-së, Melania Trump



PRISHTINË, 16 MARS - Me ftesën e Zonjës së Parë të ShBA-së, Melania Trump, në kuadër të nismës së saj Fostering the Future Together (FFT), Zotëria i Parë i Republikës së Kosovës, Prindon Sadriu, do të marrë pjesë në takimin inaugurues të Koalicionit Botëror të FFT i cili do të mbahet në Shtëpinë e Bardhë dhe në Departamentin Amerikan të Shtetit, më 24 dhe 25 mars.

Pjesëmarrja e Kosovës në këtë koalicion krijon mundësi të jashtëzakonshme që nxënësit dhe fëmijët tanë të përfitojnë nga projektet, programet dhe inovacionet e kompanive më të njohura amerikane të teknologjisë, përfshirë platforma të avancuara digjitale, inteligjencë artificiale dhe mjete të reja edukative që mbështesin zhvillimin, kreativitetin dhe sigurinë online të tyre, gjithnjë duke vendosur në fokus mbrojtjen dhe mirëqenien e të rinjve dhe fëmijëve.

Me iniciativë të presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, Kosova iu bashkua kësaj nisme ndër shtetet e para në botë, duke dëshmuar përkushtimin për t'u siguruar fëmijëve mbrojtje në epokën e mundësive më të avancuara të botës digjitale.

# KALLASI THOTË SE ËSHTË E GATSHME TË PRESË "SË SHPEJTI" NJË TAKIM TË NIVELIT TË LARTË MES KOSOVËS E SERBISË

PRISHTINË, 16 MARS - Shefja e politikës së jashtme e Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, ka thënë të shtunën se është e gatshme ta ndërmjetësojë "së shpejti" një takim të nivelit të lartë në mes të Kosovës dhe Serbisë, pasi autoritetet e Kosovës mundësuan lehtësira të përkohshme për komunitetin serb në Ligjin për të Huajt.

Në një shkrim në X, Kallasi tha se "është krijuar një momentum i ri për t'i çuar përpara marrëdhëniet mes BE-së dhe Kosovës dhe dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit". Kjo pasi kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është pajtuar t'u ofrojë leje të përkohshme qëndrimi dhe t'ua njohë përkohësisht letërnjoftimet pjesëtarëve të komunitetit serb që nuk janë të pajisur me dokumente të Kosovës. "Marrëveshja e sotme për regjistrimin civil dhe Ligjin për të Huajt shënon një hap të rëndësishëm përpara në dobi të të gjithë njerëzve në Kosovë. Është thelbësore të sigurohet vazhdimësia në ofrimin e shërbimeve publike", tha Kallasi.

Kosova synon t'i shkrijë institucionet paralele serbe të shëndetësisë dhe arsimit në sistemin e vet përfundimisht përmes këtij ligji që do të fillojë të zbatohet plotësisht nga e diela e 15 marsit. Por, qeveria Kurtit u pajtua pas një takimi të shtunën me të dërguarin e BE-së për dialogun, Peter Sorensen, që pjesëtarët e komunitetit serb pa dokumente të Kosovës të kenë mundësi të marrin leje të përkohshme qëndrimi prej 12-muajsh si dhe të bartin përkohësisht si mjet identifikimi letërnjoftimet e lëshuara nga autoritetet serbe.

### Dialogu në Bruksel

Vitet e fundit Kosova dhe Serbia kanë zhvilluar një sërë raundesh të dialogut në nivel kryenegociatorësh, por takime të nivelit të lartë politik nuk ka pasur që nga shtatori i vitit 2023.

Atëbotë raundi i fundit i dialogut në nivel të lartë u zhvillua pak ditë para sulmit të armatosur në Banjskë të Zveçanit, kur një grup i serbëve të armatosur vranë një polic të Kosovës.

Kosova e fajëson Serbinë për këtë sulm, por Beogradi mohon se ka gisht në të.

Vazhdimi i dialogut në nivel të lartë ngeci pas atij sulmi, pasi Kurti e lidhi atë me dorëzimin e autorit të dyshuar, Millan Radoiçiq, veprim të cilin Serbia nuk e ka bërë deri më sot.




Mbi një dekadë dialog, Kosova dhe Serbia kanë arritur një sërë marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar.

Më 2023 palët arritën Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit, e njohur edhe si Marrëveshja e Ohrit, por BE-ja ka thënë se ajo ende nuk është zbatuar.

Ndonëse kjo marrëveshje nuk është nënshkruar, sipas bllokut evropian, ajo është e detyrueshme për të dyja palët.

# JETON KOCA JEP DORËHEQJE NGA POZITA E PROKURORIT TË PROKURORISË THEMELORE NË PRISHTINË

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 16 MARS - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), nën kryesimin e Arian Gashit, ka mbajtur takim të jashtëzakonshëm, në të cilin janë shqyrtuar çështjet e parapara sipas rendit të ditës. Pas diskutimeve dhe shqyrtimit të materialeve përkatëse, KPK-ja ka marrë disa vendime.




Këshilli miratoi dorëheqjen e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Jeton Koca. Në përputhje me procedurat ligjore në fuqi, KPK-ja do t'i përcjellë presidencës së Republikës së Kosovës propozimin për dekretimin e dorëheqjes së tij nga funksioni i prokurorit.

Po ky këshill ka miratuar dorëheqjen e anëtares së Këshillit Prokurorial të Kosovës, Elza Kastrati-Bajrami, nga pozita e zëvendëskryeprokurores së Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

KPK-ja themeloi Panelin Hetimor për shqyrtimin e një rasti disiplinor ndaj një prokurori të Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Në përbërje të këtij paneli, të përzgjedhur përmes shortit, u caktuan: kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Arben Kadriu - kryesues; prokurori në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Fatos Ajvazi - anëtar dhe prokurori në Prokurorinë Themelore në Gjilan, Arben Ismajli - anëtar.

Ndërkaq anëtarë rezervë u caktuan: prokurorja në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, Ardita Hyseni dhe prokurorja në Prokurorinë Themelore në Pejë, Sanije Seferi.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Arian Gashi, njoftoi anëtarët e KPK-së për dorëheqjen e tij të parevokueshme nga dy funksionet që ka ushtruar deri më tani, përkatësisht nga pozita e kryesuesit të grupit punues për monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit të sistemit prokurorial për periudhën 2025-2027, si dhe nga pozita e kryesuesit të Komisionit Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, pozita këto vakante, të cilat do të plotësohen në takimet e radhës së KPK-së.

## Gjysma e shkollave me probleme sigurie, komuna e Prishtinës paralajmëron masa konkrete

PRISHTINË, 16 MARS - Raporti i sigurisë i realizuar në shkollat e kryeqytetit nga Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca ka treguar se rreth 50 % e shkollave kanë çështje të sigurisë ku duhet të intervenohet. Duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj çështjeje, kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka ftuar në takim drejtorët e të gjitha shkollave të kryeqytetit, së bashku me Policinë e Kosovës, zjarrfikësit dhe drejtorët e Arsimit, Inspeksionit, Investimeve Kapitale, Transformimit, Mobilitetit, Shërbimeve Publike, si dhe Sigurisë dhe Emergjencave.

"Qëllimi i këtij takimi është që ta shqyrtojmë në detaje raportin e sigurisë dhe të identifikojmë menjëherë hapat konkretë që duhet të ndërmerren. Në këtë proces, çdo drejtori do të marrë përgjegjësitë që i takojnë sipas fushës së saj, ndërsa një pjesë e masave do të adresohen edhe nga vetë menaxhmentet e shkollave. Siguria në shkolla është një përgjegjësi e përbashkët institucionale dhe shoqërore. Zero kompromis kur është në pyetje siguria e fëmijëve tanë", ka thënë kryetari Rama.



# BQK-ja hap aktivitetet e Javës Globale të Parasë 2026, ndan çmimet e garave dhe shpall 'Çmimin për Ekonomistë të Rinj'

Prishtinë, 16 mars - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) hapi aktivitetet e Javës Globale të Parasë (GMW) 2026, një iniciativë globale që synon promovimin e edukimit financiar dhe zhvillimin e aftësive financiare tek të rinjtë.
Si pjesë e ceremonisë hapëse u ndanë edhe çmimet e konkursit edukativ "Stock Market Learning Competition".
Në këtë aktivitet morën pjesë drejtori menaxhues i Sparkassenstiftung, Niclaus Bergmann, zëvendësambasadori nga Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë, Christian Böttcher, si dhe studentë, përfaqësues të universiteteve dhe partnerë institucionalë.
Java Globale e Parasë është një fushatë ndërkombëtare e koordinuar nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), e cila bashkon bankat qendrore, institucionet financiare dhe institucionet arsimore për ta rritur ndërgjegjësimin e të rinjve për rëndësinë e edukimit financiar dhe vendimmarrjes së përgjegjshme financiare.
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është pjesë e kësaj iniciative për të 13-n vit me radhë.
Në fjalën e tij në ceremoninë hapëse, guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, theksoi rëndësinë e edukimit financiar për fuqizimin e qytetarëve dhe për zhvillimin e një sistemi financiar të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Ai nënvizoi se BQK mbetet e përkushtuar në promovimin e edukimit financiar, mbrojtjen e konsumatorit dhe rritjen e përfshirjes financiare në vend.
Guvernatori Ismaili theksoi se gjatë viteve BQK ka ndërmarrë një sërë iniciativash për ta rritur ndërgjegjësimin financiar të qytetarëve.
Ndër këto iniciativa përfshihet platforma për krahasimin e produkteve dhe shërbimeve financiare, e cila ofron transparencë mbi tarifat dhe kushtet e institucioneve financiare, si dhe një sërë aktivitetesh edukative me nxënës dhe studentë nga institucionet arsimore në të gjithë vendin.
BQK gjithashtu ka zhvilluar iniciativa për promovimin e përfshirjes financiare, përfshirë aktivitete që synojnë përmirësimin e qasjes në




shërbime financiare për personat me aftësi të kufizuara, si dhe programe bashkëpunimi me universitete dhe institucione arsimore për të nxitur interesimin e të rinjve për ekonominë dhe financat.
Si pjesë e ceremonisë së sotme u ndanë çmimet për fituesit e Stock Market Learning Competition, një garë edukative e zhvilluar në bashkëpunim me German Sparkassenstiftung for International Cooperation. Kjo garë u mundësoi studentëve nga fakultete ekonomike të Kosovës të përjetojnë në mënyrë praktike funksionimin e tregjeve financiare përmes simulimit të tregtimit në bursën virtuale të Stuttgartit. Në këtë garë morën pjesë 42 studentë nga tetë fakultete të ekonomisë dhe biznesit, të cilët përmes kësaj përvoje zhvilluan njohuri dhe aftësi praktike në fushën e investimeve dhe tregjeve financiare.
Gjithashtu, u ndanë çmimet për fituesit e kuizit financiar për nxënësit e shkollave të mesme, ku shpërblehen 6 nxënës nga shkolla të ndryshme të Kosovës.
Në kuadër të aktiviteteve të Javës Globale të Parasë 2026, BQK njoftoi gjithashtu për hapjen e thirrjes për aplikim për çmimin "Çmimi për Ekonomistët e Rinj", i cili synon të inkurajojë studentët dhe studiuesit e rinj të kontribuojnë me punime kërkimore inovative në fushën e ekonomisë dhe financave.
Paraprakisht, guvernatori i BQK-së zhvilloi gjithashtu një takim me drejtorin menaxhues të German Sparkassenstiftung for International Cooperation, Niclaus Bergmann, gjatë të cilit diskutuan mbi zhvillimet në sektorin financiar në Kosovë dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm ndërmjet BQK-së dhe Sparkassenstiftung në fushën e edukimit financiar dhe zhvillimit të kapaciteteve institucionale.
Guvernatori Ismaili shprehu mirënjohjen për mbështetjen dhe partneritetin e vazhdueshëm të Sparkassenstiftung, përfshirë bashkëpunimin në organizimin e garës Stock Market Learning Competition dhe iniciativave të tjera që kontribuojnë në avancimin e edukimit financiar në Kosovë.
Gjatë kësaj jave BQK-ja do të zhvillojë edhe një sërë aktivitetesh edukative në bashkëpunim me institucione arsimore dhe partnerë të sektorit financiar, duke përfshirë gara dhe aktivitete ndërgjegjësuese për nxënës dhe studentë në të gjithë vendin.

# MBPZHR-ja organizon punëtori dyditore, në fokus politikat mbështetëse për bujqësinë

Prishtinë, 16 mars - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) ka nisur punëtorinë dyditore me temën "Politikat mbështetëse përmes Programit të Pagesave Direkte (PPD), Programit të Zhvillimit Rural (PZhR) dhe projektet në sektorin e ujitjes", me qëllim të diskutimit dhe avancimit të politikave mbështetëse për zhvillimin e sektorit bujqësor në Republikën e Kosovës.
Punëtorinë e hapi ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Armend Muja, i cili theksoi se politikat mbështetëse për fermerët dhe prodhuesit vendorë mbeten një nga prioritetet kryesore të



ministrisë. "Prioritetet tona kryesore mbeten rritja e prodhueshmërisë në bujqësi, përkrahja e fermerëve të rinj dhe krijimi i mundësive për diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në zonat rurale. Një vëmendje e veçantë po i kushtohet edhe zhvillimit të sistemit të ujitjes, si dhe sektorit të pyjeve, i cili ka potencial të madh zhvillimor. Për këtë arsye, më 21 të këtij muaji do të plasohet programi i ri për sektorin e pyjeve, ndërsa javën e ardhshme do të prezantojmë edhe programin për sistemin e ujitjes", tha ministri Muja.
Në këtë punëtori mori pjesë edhe sekretarja e përgjithshme e Ministrisë së Bujqësisë, Venera Çerkini, përfaqësues të departamenteve dhe sektorëve të ndryshëm të ministrisë, si dhe ekspertë të politikave bujqësore dhe zyrtarë institucionalë.
Gjatë punimeve të punëtorisë diskutimet do të fokusohen në zbatimin dhe efektet e Programit të Pagesave Direkte, me theks të veçantë në: sektorin e drithërave, sektorin e drithërave - Masa 1, sektorin e hortikulturës, si dhe në masën e sigurimeve bujqësore - Masa 5, Masa 10, Masa 11.
Në kuadër të punëtorisë u trajtuan gjithashtu sfidat aktuale të fermerëve në këta sektorë, përmirësimi i skemave mbështetëse dhe rritja e efikasitetit të programeve të subvencioneve dhe investimeve në bujqësi.
Punëtoria dyditore synon të shërbejë si një platformë për shkëmbimin e përvojave profesionale, identifikimin e sfidave dhe avancimin e politikave që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm dhe modernizimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë.

## ASK-ja: Ekonomia e Kosovës u rrit për 3.85 % në fund të vitit 2025

Prishtinë, 16 mars - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat e Bruto Produktit Vendor për tremujorin i katërt (TM4) të vitit 2025, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve, me çmime aktuale dhe me çmime të vitit paraprak. Sipas ASK-së, BPV-ja në TM4 2025 shënon rritje reale për 3,85 %, krahasuar me TM4 2024
Aktivitetet ekonomike që kishin rritje në këtë tremujor ishin: Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, transporti dhe magazinimi; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor (5,71 %); Aktivitetet financiare dhe të sigurimit (5,16 %); Informacioni dhe komunikimi (4,98 %); Artet, argëtimi dhe çlodhja, aktivitetet e prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera (4,95 %); Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike, aktivitetet e shërbimeve administrative dhe mbështetëse (4,64 %); Industria përpunuese (4,59 %); Industria nxjerrëse, përpunuese, energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër, furnizimi me ujë; aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit (4,54 %); Bujqësia, pyjet dhe peshkimi (4,12 %); Ndërtimtaria (3,90 %); Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi social i detyrueshëm, arsimi, shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale (1,43 %); dhe Aktivitetet e pasurive të paluajtshme (1,31 %).
Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rritje ishin: Eksporti i mallrave dhe shërbimeve (11,49 %); Formimi i bruto kapitalit



(3,45 %); Importi i mallrave dhe shërbimeve (1,95 %); Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH (0,62 %). Ndërsa rënie kishin: Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (-1,03 %).

# PAKICA QË "BËRTET". PSE RRJETET SOCIALE KRIJOJNË ILUZIONIN E SHUMICËS



Në rrjetet sociale, ai që duket si mendimi i shumicës shpesh nuk është aspak shumicë. Është thjesht zëri më i lartë, më i shpeshtë dhe më agresiv. Një grup i vogël përdoruesish, shumë aktivë dhe shpesh më ekstremë në qëndrime, arrijnë të krijojnë përshtypjen se përfaqësojnë të gjithë. Kështu lind një nga shtrembërimet më të rrezikshme të epokës digjitale: iluzioni i shumicës. Dhe kur njerëzit nisin të heshtin, vetëm sepse mendojnë se janë në pakicë, ky iluzion bëhet edhe më i fortë.

## Çfarë është iluzioni i shumicës?

Rrjetet sociale amplifikojnë zërin e atyre që flasin më shumë, por kjo nuk do të thotë se ata përfaqësojnë shumicën. Kjo sjell një fenomen të quajtur iluzion kolektiv – një situatë ku shumica e njerëzve shkojnë pas një ideje që në fakt nuk e mbështesin, vetëm sepse mendojnë se shumica tjetër e grupit e mbështet. Si pasojë, grupi vepron në mënyra që pak njerëz në të vërtetë i pëlqejnë.

Ky iluzion ndikon në mënyrën se si e konceptojmë jetën, marrëdhëniet, dhe institucionet. Rrjetet sociale veprojnë si një dhomë pasqyrash që shtrembëron realitetin.

Problemi nuk është vetëm se disa flasin më shumë. Problemi është se algoritmet i shpërblejnë pikërisht ata. Përmbajtja më emocionale, më polarizuese dhe më provokuese ka më shumë gjasa të komentohet, të shpërndahet dhe të marrë reagime. Kjo krijon një cikël ku ekstremi bëhet më i dukshëm se normalja, ndërsa zërat më të ekuilibruar zhduken në sfond.

## Pse rrjetet sociale e shtrembërojnë realitetin

80% e përmbajtjes në rrjetet sociale krijohet nga vetëm 10% e përdoruesve – një grup që shpesh ka qëndrime ekstreme, në lidhje me shumicën e çështjeve sociale. Ky grup krijon iluzionin e një shumice që mendon, duke heshtur shumë të tjerë. Kjo është arsyeja pse shumica prej nesh ose e detyrojmë veten të heshtim, ose pranojmë me kokëulje, duke e bërë këtë iluzion një profeci të vetë-përmbushur.

Kjo ka pasoja të drejtpërdrejta në jetën reale. Njerëzit fillojnë të besojnë se mendimi i tyre është "jashtë kohe", "i papranueshëm" ose "në pakicë", edhe kur në fakt nuk është. Për të shmangur sulmin, talljen apo izolimin, shumë zgjedhin të heshtin. Kështu krijohet një spirale heshtjeje: sa më shumë hesht shumica, aq më e fortë duket pakica që dominon ekranin.

## Si një pakicë shumë aktive dominon debatin online

Nuk është çudi që liderët që kërkojnë të ruajnë pushtetin janë të parët që përdorin këto mjete për të manipuluar mendimin publik. Një shembull është Nicolas Maduro, lideri i Venezuelës. Për një kohë të gjatë, në rrjetet sociale dukej sikur ai kishte mbështetje të gjerë. Çdo deklaratë e tij pozitive ripostohej dhe shpërndahej gjerësisht. Por, shumë nga këto "ndjekës" dolën të jenë të ashtuquajturat bots – llogari false që ekzistonin vetëm për të përforcuar mesazhet e tij dhe për të sulmuar opozitën.

Në këtë mënyrë, rrjetet sociale nuk pasqyrojnë thjesht realitetin: ato shpesh e deformojnë atë. Ajo që shohim online nuk është domosdoshmërisht ajo që mendojnë njerëzit në të vërtetë, por ajo që platforma vendos të amplifikojë. Prandaj, për të kuptuar më mirë shoqërinë, nuk mjafton të shohësh trendet apo komentet më të zhurmshme; duhet të dëgjosh edhe ata që nuk bërtasin.

## Si të mos biesh pre e iluzioneve kolektive

Rrjetet sociale janë një arenë ku kushdo mund të bërtasë më fort ose të heshtë të tjerët duke u maskuar si shumicë. Nëse heshtim dhe nuk sfidojmë atë që mendojmë se beson grupi, ndihmojmë që ai grup të shkojë në drejtimin e gabuar.

Për të shmangur ndikimin e iluzioneve kolektive, duhet të gjejmë kohë për të dalë jashtë hapësirës virtuale dhe për të ndërtuar lidhje reale. Bisedat me familjen, fqinjët dhe komunitetin janë çelësi për të ruajtur një perspektivë të shëndetshme.

Nuk duhet lejuar që shtrembërimi i rrjeteve sociale të ndikojë në mënyrën se si i trajtojmë njerëzit në jetën reale. Ndërkohë që rrjetet sociale nuk do të zhduken, fuqia e tyre për të krijuar iluzione mund të kufizohet kur secili nesh vendos të flasë dhe të qëndrojë i vërtetë ndaj mendimeve dhe vlerave të veta.

Shumica e vërtetë nuk është gjithmonë ajo që duket në ekran. Shpesh, ajo është e heshtur, e lodhur, e painteresuar për konfliktin e përhershëm online. Por heshtja e saj i jep më shumë fuqi pakicës që bërtet. Dhe pikërisht këtu qëndron rreziku më i madh i rrjeteve sociale: jo vetëm se na tregojnë një realitet të shtrembëruar, por se na bindin ta pranojmë atë si të vërtetë. / bota.al

# TETË VITE NGA ZYRTARIZIMI I GJUHËS SHQIPE NË MAQEDONI TË VERIUT



Ismet SYLEJMANI



Fitore historike e shqiptarëve në Maqedoni të Veriut është Zyrtarizimi i Gjuhës Shqipe!
Më 14 Mars të vitit 2018, kalendari kombëtar shënon me krenari 8-vjetorin e një arritjeje historike për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, Zyrtarizimin e Gjuhës Shqipe në institucionet e shtetit!
Zyrtarizimi i Gjuhës Shqipe nuk ishte vetëm një fitore ligjore, por ajo ishte edhe një fitore e madhe politike, kombëtare dhe historike e popullit shqiptar në Maqedoninë e Veriut!
Zyrtarizimi i Gjuhës Shqipe është arritje e madhe e cila mban vulën e përkushtimit dhe vizionit përmanenet të Partisë Bashkimit Demokratik për Integrim dhe të Kryetarit të saj, Udhëheqësit te popullit, Atdheut dhe Kombit Ali Ahmeti, i cili me vendosmëri, largpamesi dhe mençuri politike udhëhoqi provesin progresiv në rrugën drejt barazisë së plotë të shqiptarëve në shtetin e Maqedonisë së Veriut!
Nga idealet e mëdha te stërgjyshërve, gjyshërve e baballarëve të luftës për liri, nga sakrificat e Dëshmorëve dhe Heronjve të Kombit, deri te përpjekjet e mëdha politike dhe institucionale, rruga drejt zyrtarizimit të shqipes së folur dhe të shkruar në institucionet e Maqedonisë së Veriut, ishte një rrugë e gjatë dhe e vështirë!
Por me unitet të plotë, me vizion dhe udhëheqje të drejtë, kjo ëndërr shekullore më 14 Mars 2028 u bë realitet!
Simbolika e kësaj fitoreje bëhet edhe më e fuqishme kur kujtojmë se pikërisht në Qytetin e Manastirit, më 1908, u mbajt Kongresi Historik i Gjuhës Shqipe, ku u vendos Alfabeti i shkronjave latine!
Pas më shumë se një shekulli, gjuha që mori formë në Manastir më 1908, sot ndonëse me shume pengesa të Partise në pushtet VMRO, flitet dhe shkruhet zyrtarisht në institucionet e shtetit të Maqedonisë se Veriut!
Ky përvjetor është dëshmi se kur një popull është i bashkuar dhe i udhëhequr nga vizioni i drejtë, fitoret janë të pashmangshme dhe marshimi përpara drejt fitoreve i paevitueshem!
Lideri i madh kombëtar Ali Ahmeti dhe BDI ishin dhe mbeten arkitektët e kësaj fitoreje historike, duke e ngritur çështjen e Gjuhës Shqipe në nivelin madhor që i takon!
Lavdi dëshmorëve të kombit!
Nderim për të gjithë ata që sakrifikuan për liri dhe barazi në Maqedoninë e Veriut!
Popull Shqiptar në Maqedoni te Veriut, urime 8-vjetori i Zyrtarizimit të Gjuhës Shqipe!
Prishtinë, 14 Mars 2026!

Fitore historike e shqiptarëve në Maqedoni të Veriut është Zyrtarizimi i Gjuhës Shqipe!
Më 14 Mars të vitit 2018, kalendari kombëtar shënon me krenari 8-vjetorin e një arritjeje historike për shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, Zyrtarizimin e Gjuhës Shqipe në institucionet e shtetit!
Zyrtarizimi i Gjuhës Shqipe nuk ishte vetëm një fitore ligjore, por ajo ishte edhe një fitore e madhe politike, kombëtare dhe historike e popullit shqiptar në Maqedoninë e Veriut!
Zyrtarizimi i Gjuhës Shqipe është arritje e madhe e cila mban vulën e përkushtimit dhe vizionit përmanenet të Partisë Bashkimit Demokratik për Integrim dhe të Kryetarit të saj, Udhëheqësit te popullit, Atdheut dhe Kombit Ali Ahmeti, i cili me vendosmëri, largpamesi dhe mençuri politike udhëhoqi provesin progresiv në rrugën drejt barazisë së plotë të shqiptarëve në shtetin e Maqedonisë së Veriut!
Nga idealet e mëdha te stërgjyshërve, gjyshërve e baballarëve të luftës për liri, nga sakrificat e Dëshmorëve dhe Heronjve të Kombit, deri te përpjekjet e mëdha politike dhe institucionale, rruga drejt zyrtarizimit të shqipes së folur dhe të shkruar në institucionet e Maqedonisë së Veriut, ishte një rrugë e gjatë dhe e vështirë!
Por me unitet të plotë, me vizion dhe udhëheqje të drejtë, kjo ëndërr shekullore më 14 Mars 2028 u bë realitet!
Simbolika e kësaj fitoreje bëhet edhe më e fuqishme kur kujtojmë se pikërisht në Qytetin e Manastirit, më 1908, u mbajt Kongresi Historik i Gjuhës Shqipe, ku u vendos Alfabeti i shkronjave latine!
Pas më shumë se një shekulli, gjuha që mori formë në Manastir më 1908, sot ndonëse me shume pengesa të Partise në pushtet VMRO, flitet dhe shkruhet zyrtarisht në institucionet e shtetit të Maqedonisë se Veriut!
Ky përvjetor është dëshmi se kur një popull është i bashkuar dhe i udhëhequr nga vizioni i drejtë, fitoret janë të pashmangshme dhe marshimi përpara drejt fitoreve i paevitueshem!
Lideri i madh kombëtar Ali Ahmeti dhe BDI ishin dhe mbeten arkitektët e kësaj fitoreje historike, duke e ngritur çështjen e Gjuhës Shqipe në nivelin madhor që i takon!

*Lavdi dëshmorëve të kombit!*
Nderim për të gjithë ata që sakrifikuan për liri dhe barazi në Maqedoninë e Veriut!
Popull Shqiptar në Maqedoni te Veriut, urime 8-vjetori i Zyrtarizimit të Gjuhës Shqipe!
**Prishtinë, 14 Mars 2026!**



12 EPOKA E RE E PREMTE, 16 MARS 2018 OPINION

Manastiri në Maqedoni edhe de jure, nën udhëhëqjen e Ali Ahmetit, flet shqip

## MANASTIRI EDHE DE JURE FLET SHQIP

Ismet SYLEJMANI

Në këtë vit mbushen 110 vjet nga koha kur është mbajtur Kongresi i Manastirit, dhe më 14 mars 2018 Parlamenti i Maqedonisë, nën drejtimin e komandantit të UÇK-së, figurës madhore të popullit shqiptar Talat Xhaferi, bëri realitet ligjor e kushtetues zyrtarizimin e gjuhës shqipe në Maqedoni.
Populli shqiptar në Maqedoni e ka në sofrën e vet - Manastirin, qytetin historik të shkronjave të shqipes.
Manastiri i Maqedonisë po bëhet i fundit që edhe de jure do të flasë shqip, ndonëse ishte i pari që i vendosi themelet e shqipes.
Manastiri edhe de jure nuk do të mund të fliste shqip, sikur në podiumin historik të udhëheqjes së popullit shqiptar jo vetëm në Maqedoni, të mos ngjitej udhëheqësi i madh e i lavdishëm i popullit shqiptar, Ali Ahmeti.
Kombi ynë sot është në festë.
Buzëqeshin kryeudhëheqësit e Kombit.
Delegatët e Kongresit historik të Manastirit gëzohen, edhe pse është vonë kjo e arritur, por ata nuk e dinë se sa shumë ka vuajtur populli shqiptar që e ka folur dhe ruajtur gjuhën shqipe në Maqedoni.
Emblemat historike të ushtrive çlirimtare sot shkëlqejnë edhe më shumë.
Në ballin e festës së popullit shqiptar në Maqedoni, pos gjakut të derdhur për liri nga heronjtë dhe dëshmorët e atdheut, sikur gjithmonë, është ilegali i famshëm, udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti, shoku e bashkëluftëtari i heroit të kombit Fehmi Lladrovci dhe shumë të rënëve për liri dhe shokëve të gjallë, të cilët së bashku i gëzohen kësaj ngjarje epokale e historike.
Vijnë e do të vijnë ditë edhe më të mira, do të shënohen të arritura të mëdha e të gjithanshme, por ajo tani e tutje do të kenë një të veçantë, sepse do të jenë të shënuara e të shoqëruara edhe nga shqipja zyrtare edhe në Maqedoni, ashtu sikur në Kosovë e Shqipëri.
Prishtinë, 14 mars 2018!




# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

## Kryeziu shpallet "Ylli i Javës" në Superligë




PRISHTINË, 16 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në bashkëpunim me sponsorin zyrtar të Superligës, Albi Mall, vazhdon ndarjen e çmimit tradicional "Ylli i Javës", i cili i dedikohet futbollistit më të dalluar të javës në Superligën e futbollit të Kosovës. Për javën e 24 të këtij edicioni ky çmim i është dhënë futbollistit të FC Ballkani, Almir Kryeziu, i cili ka shënuar gol dhe ka asistuar në një gol tjetër në ndeshjen kundër FC Drita, e cila ka përfunduar me rezultatin 3:0. Me këtë rast, Kryeziu është shprehur i lumtur që është vlerësuar lojtari më i mirë i javës. "Ka qenë një ndeshje e vështirë, sepse Drita ka një skuadër shumë të mirë. E kemi përgatitur shumë mirë ndeshjen dhe jemi shumë të lumtur për këtë fitore. Jemi në vendin e parë me pikë të barabarta, por kemi edhe shumë ndeshje të cilat do t'i luftojmë. Falënderoj komisionin për vlerësimin, Klubin FC Ballkani dhe jam i lumtur që jam në formë dhe po mund ta ndihmoj ekipin", ka thënë Kryeziu.

## ADEMI TAKOHET ME KONJUFCËN, MERR MBËSHTETJE PËR RRUGËTIMIN E KOSOVËS DREJT KUPËS SË BOTËS



PRISHTINË, 16 MARS - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë, ka vizituar zëvendëskryeministrin dhe kryediplomatin Glauk Konjufca. Ademi ka bërë me dije se me Konjufcën kanë biseduar për përgatitjet që është duke i bërë Kombëtarja e Kosovës për ndeshjen kundër Sllovakisë në kuadër të "play-off"-it për Kupën e Botës 2026. Ademi ka thënë se kanë marrë mbështetje nga Konjufca, duke shtuar se institucionet shtetërore do t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për ta mbështetur Kosovën në këtë rrugëtim historik. "Sot së bashku me anëtarin e KE të FFK-së, Samir Ujkani dhe menaxherin e ekipit kombëtar, Bajram Shala, zhvilluam një vizitë pune te zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca. Gjatë takimit e informuam zëvendëskryeministrin për përgatitjet rreth ndeshjes së rëndësishme kundër Sllovakisë, në kuadër të 'play-off'-it për Kupën e Botës 2026, si dhe për organizimin e udhëtimit të ekipit tonë drejt Bratisllavës. Ai na përgëzoi për rezultatet e arritura deri më tani, duke theksuar se puna ekipore dhe angazhimi i përbashkët kanë sjellë fitore të rëndësishme dhe e kanë përfaqësuar denjësisht vendin tonë në arenën ndërkombëtare. Gjithashtu vuri në pah se institucionet shtetërore do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për ta mbështetur Kosovën në këtë rrugëtim historik. E falënderuam zëvendëskryeministrin për pritjen e ngrohtë dhe për mbështetjen e vazhdueshme të institucioneve të Republikës së Kosovës ndaj ekipit tonë kombëtar në rrugëtimin tonë drejt realizimit të synimeve tona", ka shkruar Ademi në "Facebook".

## BALLKANI RIKTHEHET NË KRYE TË SUPERLIGËS

Prishtinë, 16 mars - Ballkani ka shënuar fitore bindëse në derbin e xhiros së 24-t të AlbiMall Superligës së Kosovës, duke e mposhtur Dritën me rezultat 3:0 dhe duke u rikthyer në vendin e parë në tabelë. Ndeshja e zhvilluar në Suharekë është dominuar nga skuadra vendase që ka arritur t'i shfrytëzojë rastet dhe të sigurojë tri pikë shumë të rëndësishme në garën për titull. Ballkani e ka nisur ndeshjen në mënyrën më të mirë të mundshme, pasi në minutën e tretë Bleart Tolaj ka realizuar një supergol për epërsinë 1:0. Vendasit kanë vazhduar të jenë më kërkues në sulm dhe në minutën e 38 Arbër Potoku e ka dyfishuar epërsinë, duke bërë që pjesa e parë të përfundojë me rezultatin 2:0 në të mirë të portokallezinjve. Në pjesën e dytë Ballkani ka menaxhuar mirë lojën dhe në minutën e 79 ka finalizuar një aksion të bukur, kur Almir Kryeziu ka realizuar për rezultatin përfundimtar 3:0, pas një superasistimi nga Ribeiro. Pas




këtij fitoreje Ballkani është rikthyer në krye të tabelës me 42 pikë, aq sa ka edhe Drita në vendin e dytë, ndërsa të dyja skuadrat kanë krijuar shkëputje prej katër pikësh nga ndjekësit dhe pritet të zhvillojnë një garë të fortë për titull deri në fund të kampionatit.

Fitore të rëndësishme në këtë xhiro ka shënuar edhe Llapi, që në Klinë e ka mposhtur Dukagjinin me rezultat 2:1. Pas kësaj fitoreje Llapi është forcuar në vendin e shtatë me 29 pikë, ndërsa Dukagjini mbetet në vendin e gjashtë me 33 pikë. Fitore të rëndësishme kanë shënuar Drenica dhe Ferizaj duke mposhtur Gjilanin përkatësisht Malishevën, ndërsa Prishtina ka ndarë pikët me Prishtina e Re.

**SUPERLIGA, RENDITJA TABELARE E KLUBEVE**

| | |
|---|---|
| Ballkani | 42 |
| Drita | 42 |
| Prishtina | 38 |
| Malisheva | 37 |
| Gjilani | 36 |
| Dukagjini | 33 |
| Llapi | 29 |
| Ferizaj | 26 |
| Drenica | 25 |
| Prishtina e Re | 23 |

## KOMBËTARJA E KOSOVËS NË HENDBOLL PËRGATITET PËR NDESHJEN ME BOSNJË-HERCEGOVINËN



PRISHTINË, 16 MARS - Hendbollistët e Kombëtares së Kosovë kanë nisur grumbullimin për dy ndeshjet e fazës së dytë kualifikuese për Botërorin 2027. Të dyja ndeshjet Kosova i luan kundër Bosnjë-Hercegovinës dhe për këtë arsye kjo vlerësohet java e hendbollistëve "dardanë". Kosova edhe sot (e martë) do të përgatitet në Prishtinë, përpara se nesër (e mërkurë) të niset drejt Tuzlas së Bosnjë-Hercegovinës. Ndeshjen e parë Kosova e luan të enjten nga ora 20:00 në arenën "Mejdan" në Tuzla, kurse të dielën prej orës 17:00 është ndeshja e kthimit që luhet në Prishtinë. Kombëtarja më e suksesshme pas këtyre dy ndeshjeve do të avancojë në fazën e tretë dhe të fundit kualifikuese, ku e presin përballjet me Ishujt Faroe. Kosova e ka kaluar me sukses fazën e parë kualifikuese, duke e eliminuar Britaninë e Madhe që e kishte mposhtur dy herë.

## Laporta rizgjedhet president i Barcelonës



Barcelonë, 16 mars - Joan Laporta do të shërbejë si president i Barcelonës deri në vitin 2031, pasi ka fituar zgjedhjet e mbajtura për këtë pozitë. 48 480 anëtarë të klubit spanjoll kanë votuar në qendrat e votimit në gjithë Kataloninë, në një proces zgjedhor të shumëpritur. Laporta, 63-vjeçar, ka dalë fitues përballë Victor Fontit, i cili kishte dalë i dyti edhe në zgjedhjet e vitit 2021. Para shpalljes zyrtare të rezultatit, Victor Fonti ka pranuar humbjen dhe ka thënë se nuk e kanë marrë rezultatin që shpresonin, por e respektojnë vendimin e anëtarëve. Ndërsa duke folur pas shpalljes së rezultateve, Laporta ka thënë se ky rezultat i jep Barcelonës një forcë të madhe. "Askush nuk do të na ndalojë. Na presin vite emocionuese. Do të jenë më të mirat e jetës sonë", ka thënë Laporta.

BQK
BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Pozita:** Mbikëqyrës/e i/e Lartë Bankar (2 pozita)
**Niveli i gradës:** P05
**Kohëzgjatja e punësimit:** me afat të pacaktuar
**Departamenti:** Departamenti i Mbikëqyrjes Bankare
**Divizioni:** Divizioni për Mbikëqyrjen në Vend të Bankave
**I raporton:** Udhëheqësit të Divizionit për Mbikëqyrjen në Vend të Bankave

**Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësive:**
- Kryen ekzaminimet në vend dhe shqyrton raportet e bankave;
- Udhëheqë ekipin e ekzaminerëve në ekzaminimet në vend në banka;
- Planifikon, koordinon dhe udhëheqë resurset dhe kohën e nevojshme për ekzaminimet në vend në banka;
- Përcakton fushëveprimin e ekzaminimeve në vend dhe identifikon masat detyruese pas ekzaminimit, ndaj bankave;
- Përpilon raportet e ekzaminimit dhe vlerëson përshtatshmërinë e draft raporteve të përgatitura nga ekzaminerët bankar për fushat e tyre të përgjegjësisë, në ekzaminimet në vend në banka;
- Përgatitë strategjitë mbikëqyrëse konform profilit të rrezikut të bankave dhe i rekomandon mbikëqyrësit shpeshtësinë dhe fushëveprimin e ekzaminimeve në vend;
- Identifikon rreziqet dhe veprimet detyruese si dhe rekomandon përshtatjen e strategjive mbikëqyrëse të bankave;
- Monitoron performancën financiare, zbatimin e rekomandimeve, kërkesat nga ekzaminimet në vend, si dhe zbatimin e masave detyruese të shqiptuara ndaj bankave;
- Udhëzon dhe bartë njohuritë tek mbikëqyrësit bankar dhe mbikëqyrësit e ri bankar;
- Ndihmon në përpilimin e politikave, rregulloreve, udhëzimeve, si dhe procedurave të brendshme tjera të punës;
- Detyra tjera të caktuara nga mbikëqyrësi në kudër të përgjegjësive të Departamentit të Mbikëqyrjes Bankare.

**Njohuritë akademike dhe profesionale të kërkuara:**
- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë, drejtësisë, shkencave kompjuterike, teknike, matematikës apo në fusha të tjera që lidhen me përgjegjësitë e njësive organizative, sipas përshkrimit të publikuar në uebfaqen e BQK-së;
- Preferohet të posedojë diplomë ose certifikatë profesionale ekuivalente me nivelin e kontabilistit të certifikuar dhe/ose auditorit të certifikuar.

**Përvoja profesionale e kërkuar:**
- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale në sektorin financiar ose në fushën që lidhet me përgjegjësitë e njësisë organizative, sipas përshkrimit të publikuar në uebfaqen e BQK-së;

**Aftësitë dhe njohuritë teknike:**
- Njohja e mirë e Ms. Office.
- Njohja e gjuhës angleze përparësi.

**Kërkesat e posaçme:**
- Njohuri të shquara analitike, të nevojshme për analiza financiare, si dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e menaxhimit të rreziqeve bankare në banka;
- Njohuri të shquara të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF), me qëllim të identifikimit dhe verifikimit të përshtatshmërisë së transaksioneve në regjistrimet kontabël të bankave;
- Njohuri të shquara për kuadrin ligjor, rregulloret dhe standardet aplikative të zbatueshme ndaj bankave për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre;
- Kërkohet përpikëri në respektimin e afateve për punët dhe angazhimet e caktuara nga mbikëqyrësi;
- Kërkohen aftësi të shquara për vlerësime dhe vendimmarrje të pavarur nga mbikëqyrësit;
- Kërkohet të demonstroj aftësi të shquara të komunikimit gojor, komunikimit me shkrim, të dëgjimit dhe prezantimit tek mbikëqyrësi, ekipi i ekzaminimit dhe palët tjera;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip; aftësi në menaxhimin e kohës lidhur me kompletimin dhe cilësinë e detyrave të punës; aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrësin dhe ekipin; aftësi të punuarit, diskutimit dhe bindjes me palët e jashtme;

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**
- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së gjatë aplikimit online** nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të **bashkëngjisin letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur **posaçërisht për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës, që mbulojnë paku tre (3) vite përvojë pune** (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- **Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse, që mbulon paku tre (3) vite përvojë pune**, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet
- të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

**Procedura e aplikimit:**
- Afati i fundit për aplikim është 01 prill 2026.
- Aplikimi mund të bëhet online (https://hris.bqk-kos.org) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.

BQK
BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## OGLAS O SLOBODNOM RADNOM MESTU

**Pozicija:** Viši bankarski supervizor (2 pozicije)
**Nivo ranga:** P05
**Trajanje zapošljavanja:** na neodređeni rok
**Odeljenje:** Odeljenje za bankarski nadzor
**Odsek:** Odsek za nadzor banaka u Zemlji
**Izveštava:** Rukovodiocu Odseka o nadzoru banaka u Zemlji

**Sažetak dužnosti i odgovornosti:**
- Sprovodi ispitivanja u zemlji i razmatra izveštaje banaka;
- Rukovodi timom ispitivača u ispitivanjima banaka u mestu;
- Planira, koordinira i rukovodi resursima i vreme potrebno za ispitivanja banaka u zemlji;
- Utvrđuje delokrug ispitivanja u zemlji i utvrđuje obavezne mere nakon ispitivanja, prema bankama;
- Sastavlja izveštaje o ispitivanju i procenjuje podobnost nacrta izveštaja koje pripremaju ispitivači banaka za svoje oblasti nadležnosti, u ispitivanja banaka u zemlji;
- Priprema supervizorske strategije u skladu sa profilom rizika banaka i preporučuje supervizoru učestalost i delokrug ispitivanja u zemlji;
- Identifikuje rizike i mere sprovođenja i preporučuje prilagođavanje nadzorskih strategija banaka;
- Prati finansijske rezultate, sprovođenje preporuka, zahteve iz ispitivanja u zemlji, kao i sprovođenje obavezujućih mera nametnutih bankama;
- Upućuje i prenosi znanje bankarskim supervizorima i novim bankarskim supervizorima;
- Pomaže u izradi politika, propisa, smernica, kao i drugih unutrašnjih radnih procedura;
- Ostali poslovi koje dodeljuje supervizor u okviru nadležnosti Odeljenja za nadzor banaka.

**Potrebno akademsko i profesionalno znanje:**
- Univerzitetska diploma iz oblasti ekonomije, prava, računarskih, tehničkih nauka, matematike ili iz drugih oblasti vezanih za nadležnosti organizacionih jedinica, prema opisu objavljenom na internet stranici CBK-a;
- Poželjno je da poseduje profesionalnu diplomu ili sertifikat ekvivalentan nivou ovlašćenog računovođe i/ili sertifikovanog revizora.

**Potrebno profesionalno iskustvo:**
- Imati najmanje tri (3) godine radnog iskustva u finansijskom sektoru ili u oblasti koja se odnosi na nadležnosti organizacione jedinice, prema opisu objavljenom na internet stranici CBK-a;

**Tehničke sposobnosti i znanja:**
- Dobro poznavanje Ms. Office.
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

**Posebni zahtevi:**
- Izvanredno analitička znanja, neophodna za finansijsku analizu, kao i za procenu adekvatnosti upravljanja bankarskim rizicima u bankama;
- Izvanredno poznavanje Međunarodnih standarda finansijskog izveštavanja (MSFI), u cilju identifikacije i verifikacije adekvatnosti transakcija u računovodstvenim registrima banaka;
- Izvanredno poznavanje zakonskog okvira, propisa i standarda primene koji se primenjuju na banke za procenu njihove usklađenosti;
- Potrebna je pedantnost u poštovanju rokova za poslove i obaveza koje je odredio supervizor;
- Potrebne su sposobnostiza nezavisne procene i donošenje odluka od strane supervizora;
- Potrebno je pokazati izvanrednu usmenu komunikaciju, pisanu komunikaciju, slušanja, i prezentacija veštine supervizora, ispitni tim, i druge strane;
- Sposobnost efikasnog rada u timu; sposobnosti upravljanja vremenom vezane za završetak i kvalitet radnih dužnosti; sposobnost efikasnog rada sa supervizorom i timom; sposobnost rada, diskusije i ubeđivanja spoljnih strana;

**Svi kandidati moraju poslati sledeće dokumente:**
- Prijave sa potpunim i ispravnim popunjavanjem **Službenog obrasca CBK-a tokom online prijave** neće biti razmatrane i rezultirati diskvalifikacijom tokom procesa izbora.
- Kandidati moraju **priložiti propratno pismo (motivaciono),** koje mora biti adresirano i pripremljeno **posebno za poziciju za koju se prijavljuju**; u suprotnom, prijava neće biti uzeta u razmatranje;
- **Dokaz o radnom iskustvu, koji pokriva najmanje tri (3) godine radnog iskustva** (kopije ugovora o radu, potvrde od poslodavca ili drugi relevantni dokumenti koji dokazuju radno mesto i radno iskustvo, bez kršenja relevantnih akata za zaštitu ličnih podataka).
- **Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trust) za relevantni period, koji obuhvata najmanje tri (3) godine radnog iskustva**, ili, u slučajevima kada izveštaj Fonda nije zakonski primenljiv, poresku potvrdu Poreske administracije Kosova (PAK);
- Kopije diploma, dok diplome stečene izvan Republike Kosovo moraju
- biti službeno priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

**Postupak prijave:**
- Krajni rok za prijavu je 01. april 2026. godine.
- Prijava se može izvršiti online (https://hris.bqk-kos.org) preko službene internet stranice CBK-a. Ostali obrasci za prijavu neće se uzeti u obzir.

BQK
BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Pozita:** Mbikëqyrës/e i/e Lartë për Mbikëqyrjen e IMF, IFJB, IP dhe IPE
**Grada e pozitës:** P05
**Kohëzgjatja e punësimit:** me afat të pacaktuar
**Departamenti:** Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregjeve, IMF, IFJB, IP dhe IPE
**Divizioni:** Divizioni për Mbikëqyrjen e IMF, IFJB, IP dhe IPE
**I raporton:** Udhëheqësit të Divizionit

**Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësive:**
- Zyrtari i Lartë zbaton detyrat profesionale, me mbikëqyrje dhe me udhëzime nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.
- Kryen ekzaminime në vend dhe shqyrton raportet e IMF, IFJB, IP dhe IPE;
- Udhëheqë ekipin e ekzaminerëve në ekzaminimet në vend në IMF, IFJB, IP dhe IPE;
- Planifikon, koordinon dhe udhëheqë resurset dhe kohen e nevojshme për ekzaminimet në vend për IMF, IFJB, IP dhe IPE;
- Përcakton fushëveprimin e ekzaminimeve në vend dhe identifikon masat detyruese pas ekzaminimit, ndaj IMF, IFJB, IP dhe IPE;
- Përpilon raportet e ekzaminimit dhe vlerëson përshtatshmërinë e draft raporteve të përgatitura nga ekzamineret për fushat e tyre të përgjegjësisë, në ekzaminimet në vend për IMF, IFJB, IP dhe IPE;
- Përgatit strategjitë mbikëqyrëse konform profilit të rrezikut të IMF, IFJB, IP dhe IPE dhe i rekomandon mbikëqyrësit shpeshtësinë dhe fushëveprimin e ekzaminimeve ne vend;
- Përpilon rekomandimet për masat që duhet të ndërmerren, përfshirë drafitimin e dokumenteve bazuar në rezultatet e ekzaminimit;
- Identifikon rreziqet dhe veprimet detyruese, si dhe rekomandon përshtatjen e strategjive mbikëqyrëse të IMF, IFJB, IP dhe IPE;
- Kryen mbikëqyrjen nga jashtë (off-site) të institucioneve - monitoron performancen financiare, cilësinë e raportimit të institucioneve, zbatimin e rekomandimeve, kërkesat nga ekzaminimet në vend, si dhe zbatimin e masave detyruese të shqiptuara ndaj IMF, IFJB, IP dhe IPE;
- Udhëzon dhe bartë njohuritë tek mbikëqyrësit për IMF, IFJB, IP dhe IPE si dhe mbikëqyrësit e rinj për IMF, IFJB, IP dhe IPE;
- Ndihmon në përpilimin e politikave, rregulloreve, udhëzimeve, si dhe procedurave të brendshme të punës;
- Rekomandon ndryshime në procedurat/politikat e ekzaminimit;
- Ndihmon dhe merrë pjesë në aktivitet e Divizionit të Mbikëqyrjes së Tregjeve dhe FinTech-ve, Kripto- aseteve dhe Inovacionit, në pajtim me kërkesën dhe udhëzimet e Drejtorit të Departamenti;
- Detyra të tjera të cilat i caktohen nga Udhëheqësi i Divizionit/Drejtori i Departamentit në kuadër të përgjegjësive të Departamentit dhe BQK-së.
-

**Njohuritë akademike dhe profesionale të kërkuara:**
